

Rreziku i degradimit të mjedisit dhe hartimi i një strategjie për ruajtjen e bregdetit në Himarë

Kozma Kocani, Genti Kromidha, Nihat Dragoti
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Pyjor

HYRJJE

Zona bregdetare shqiptare, përbën hapësirën më të rëndësishme e më të vlefshme nga pikpamja e zhvillimit dhe cilësisë së mjedisit. Si e tillë ajo është konsideruar pasuri e madhe vlerash të burimeve natyrore, biodiversitetit, trashëgimisë historike, kulturore, arkeologjike e turistike, të cilat duhen konservuar, mbrojtur dhe zhvilluar. Gjatë periudhës së tranzicionit, ky rajon është stresuar nga trysnia e një zhvillimi ekonomik kaotik dhe migrimi i pakontrolluar i popullsisë.

Rajoni i bregdetit Jugor karakterizohet nga një larmi e madhe habitatesh natyrore, pyje, kullota, pemë frytore, ullishta e agrume, me plazhe shkëmbore, grykëderdhje lumenjsh e përrenjësh, etj. Në disa pjesë të tij ka zona relativisht të paprekura ekollogjikisht, të cilat kërkojnë një kujdes e vëmendje të veçantë nga organet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore për ruajtjen e për një përdorim të qëndrueshëm të tyre.

Tabela e Përdorimit të Territorit

Nr	Emërtimi	Sipërfaqia Ha	% ndaj totalit
1.	Fletorë të përzier	4.021,76	12,44%
2.	Dushkaja gjëthembajtëse	1.710,86	5,29%
3.	Dushkaja gjëtherënëse	489,59	1,51%
4.	Tokë me bimësi pyjore (fletorë)	204,52	0,63%
5.	Tokë me bimësi pyjore	5.662,84	17,52%
6.	Makie mesdhetare	4.185,20	12,95%
7.	Halorë	2.063,30	6,38%
8.	Halorë të rrallë	652,41	2,02%
9.	Kullota	5.694,76	17,62%
10.	Ullishte	4.247,36	13,14%
11.	Urbane e përzier me tokë bujqësore	217,48	0,67%
12.	Plazh/Zall	83,40	0,26%
13.	Tokë e zhveshur	3.084,78	9,55%
	TOTALI	32.318,26	100,00%

Mjedisi natyror përgjatë rajonit bregdetar të Himarës është në gjëndje të mirë ekologjike dhe tepër produktiv. Megjithatë ka pak ndotje nga burimet industriale. Mundësitë e rajonit bregdetar janë: zhvillimi turistik, bujqësia, pylltaria dhe peshkimi.

Kërcënimet në rajonin bregdetar të Himarës identifikohen nga mungesa e kontrollit të shpërndarjes të ujrave të ndotur dhe nga mungesa e trajtimit të tyre, të ujrave të zeza, të mbeturinave për shkak të urbanizimit e të zhvillimit kaotik të zonës me përparësi zhvillimi të turizmit dhe mungesa e një plani urbanistik për zonën.

Ujërat e pastra të gjirit të Himarës, Dhërmiut e Palasës, ndonëse jo në përmasat e zonave të tjera bregdetare të Shqipërisë, kanë filluar të ndoten si rrjedhojë e presionit turistik të pakontrolluar nga pikpamja mjedisore. Problem përbën dëmtimi dhe degja e pyjeve e të kullotave, grumbullimi

pa kriter i bimëve mjekësore, gjuetia e kafshëve dhe shpendëve të egra, peshkimi ilegal, veçanërisht me dinamit, etj.,

Zhvillime turistike ka në qytetin e Himarës, Palasë, Dhërmi, Vuno, Qeparo, etj, të cilët kanë nevojë për përmirësime në rrugë, infrastrukturë, furnizim me ujë, kanalizime, energji, telekomunikacion, trajtim mbeturinash për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm.

Shpyllëzimet dhe diegja e pyjeve e kullotave ka shkaktuar rritje në sedimente, të cilat krijohen prej tokave pyjore dhe bujqësore Gjatë shtrengatave me shi. Degradimi i mjedisit dhe turizmi bregdetar i paplanifikuar shkaktojnë shqetësime e përndjekje në florën dhe faunën e egër të zonës. Kjo gjë ka ndodhur si rezultat i mungesës së një administrimi të koordinuar, i një autoritet rregullues dhe i mekanizmave për zbatim.

Zhvillimi i kontrolluar i turizmit në këtë rajon, sjell përmirësim të infrastrukturës të cilat lidhen dhe me zhvillimin e ekonomisë së Himarës. Kjo do të përqëndrohet me shumë në zonat e urbanizuara të Himarës. Në planet e ardhshme të administrimit, duhet të përfshihet restaurimi dhe ruajtja e biodiversitetit dhe e konservimit të natyrës, për të minimizuar ndikimet negative në këtë zonë. Përmirëimet kryesore në sistemin e infrastrukturës ekzistuese do të identifikoheshin me portet me mjete transporti të përmirësuara dhe tregtare e turistike brenda për brenda rajonit dhe nga Himara për në pjesët e tjera të bregdetit të preferuara për turizëm e vizitorët, për në Sarandë, Vlorë, Durrës, Korfuz, etj., si në përmirësimin e shërbimeve të tjera.

Për rajonin bregdetar të Himarës është i nevojshëm një plan mbrojtës të biodiversitetit, i nevojshëm për të identifikuar një serë mundësisht të zonave të mbrojtura, duke u bazuar në kërkesa të ndryshme ekologjike. Konservimi i natyrës dhe i biodiversitetit duhet të sigurojë një platformë për tipet e turizmit dhe të ndërhyrjeve në infrastrukturë të përshtatshme me mbrojtjen e mjediseve të marinës, të bregdetit, të tokave bujqësore, të pyjeve e kullotave.

Rajoni i Himarës përbëhet nga fshatrat : Palasë, Dhërmi, Vuno, Ilias, Himarë, Kudhës, Qeparo, Pilur dhe nga bashkia e Himarës. Trashëgimitë kulturore dhe arkeologjike gjenden në Dhërmi, Palasë, Vuno, Himarë, Qeparo, Pilur, Kudhëz, e Ilias, duhen evidentuar dhe ruajtur mirë. Këto trashëgimi japin një mundësi të madhe për zhvillimin e rajonit të Himarës që lidhet me tregun e turizmit kulturor, të ekoturizmit dhe ato argëtuese, shlodhëse e sportive.

Mjedisi natyror i himarës duhet i parë si bashkësi e shumë faktorëve, jo vetëm topografike dhe pozicioni gjeografik, por i lidhur ngushtë me të gjithë komponentet që e përbëjnë atë. Perspektiva e zhvillimit të këtij rajoni është e lidhur ngushtë me gjëndjen e mjedisit që e rrethon dhe impaktet që krijon njeriu si rezultat i zhvillimit.

Duke i parë përgjegjësit që kemi për atë ç'ka do t'u trashëgojmë brezave, në material trajtohet gjerësisht mjedisi në përgjithësi dhe problematika e bashkëekzistencës së njeriut në ruajtjen e ekuilibrave natyrore të rajonit të Himarës.

Në material janë trajtuar detyrimet e shtetit Shqiptar dhe te qeverisjes vendore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm si një nga detyrimet e ligjshme për t'u përfshirë në Bashkimit Evropin. Përvoja në këto vitet e fundit, ka sjellë ndryshime të koncepteve për to, por duhet këmbngulur për zbatimin e tyre, sipas një vizioni të ri. Të gjithë faktorët e mësipërm zvogëlojnë ndjeshëm ndikimet negative në mjedisin natyror, i japin përparësi krijimit dhe ruajtjes së një mjedisi sa më të shëndetshëm, duke e konsideruar atë si burimin të pazëvendësueshëm të mirëqenies dhe përparimit të rajonit.

I. Karakteristikat e përgjithshme fizike.

Himara ndodhet në pjesën Jug-Perëndimore të Shqipërisë, në Krahinen Malore Jugore (KMJ). Ka pozitë të favorshme gjeografike, pasi gjëndet në kryqëzimin e rrugës kryesore të rivierës shqiptare dhe me botën e jashtëme, nëpërmjet detit. Bregdeti është i lartë, shkëmbor, ku mbizoteron mali i Çikës. Plazhet dhe gjiret më kryesore janë: i Palasës, i Vunoit, i Dhërmiut, i Jalës, i Himarës dhe i Qeparoit.

Relievi është kryesisht malor, në masën 80%, kushtëzon shpatin si element mbizotërues. Dallohet për ndërthurjen e larmishme të elementeve të tij, mal, lugina, pllaja, etj.,



Si vend mesdhetar, Himara përfshihet në zonën klimatike mesdhetare, me dimër relativisht të shkurtër, të butë e shumë të lagësht, dhe me verë të gjatë, të nxehtë e shumë të thatë. Rreshjet përbëjnë faktorin klimatik më përcaktues për erozionin. Përqëndrohen kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit. Sipas studimeve rezulton se thatësira, që është një nga faktorët kryesorë të shkretëtirizimit, mesatarisht zgjat rreth 4-5 muaj. Rrjeti hidrografik, nuk është shumë i dendur, përbëhet nga rrjedhje të përkohshme, të cilat me rënien e rreshjeve transformohen me shpejtësi në rrjedhje të vrullshme dhe po aq shpejt niveli i tyre ulet deri sa ato shterojnë. Tokat dallohen për rezistencë jo të njëjtë ndaj erozionit. Kjo varet nga përmbajtja në humus, nga struktura e tyre etj.. Bimësia është faktori kryesor për mbrojtjen e tokës. Pylli, kullota, livadhi, bimët e arave, drurët frytor, ullishtat, agrumet, etj, ndihmojnë në zvogelimin deri në minimum të gërryerjes së tokës e shkretëtizimin e mjedisit.

II. Karakteristikat e përgjithshme ekologjike.

Rajoni është i mbuluar me bimësi të ndryshme: pyjore, kullotë, pentore, ullinjë, agrume e bimësi mjekësore e tanifere. Por roli i tyre mbrojtës përsëri është i kufizuar. Larmia e formave të relievit e petrografisë, të tipit të tokave, në kushtet e klimës mesdhetare kushtëzojnë vegjetimin e një flore të pasur, kryesisht mesdhetare. Flora e fauna (biodiversiteti) përfshijnë një numër llojesh e subllojesh endemike, ballkanike e më gjerë, duke renditur rajonin midis vendeve me biodiversitet të lartë për sipërfaqen disponibël. Po kështu, karakterizohet edhe nga një llojshmëri të ekosisteme unike përfaqësues e gati të virgjër, të cilët janë tepër të vlefshëm për sa i përket ndryshueshmërisë natyrore dhe biologjike; nga shoqërimet mesdhetare e submesdhetare; nga përrenjët, gropat, majat, qafat, kanionet, ujëvarat, bashkësitë dhe habitate të tjerë gjatë bregdetit e në thellësi të tij, etj.. Diversiteti biologjik përfshin edhe burimet natyrore e biologjike të përdorimit për qëllime tregtimi, ekonomike, mjekësore/shëndetësore etj., si prodhimet e dyta të pyllit, bimët mjekësore, aromatike, tanifere e eterovajore, etj, dhe ato jotregtare/ekonomike për përfitime turistike, ripërtëritëse dhe mjedisore.

Kërcënimet ndaj biodiversitetit janë evidente edhe gjatë kësaj periudhe tranzicioni. Mjaft ekosisteme, kryesisht ata pyjor, kullosor dhe ata detar e bregdetar, janë të kërcënuar. Për të parandaluar humbjet e mëtejshme të biodiversitetit, krahas hartimit të një strategjie për rajonin, kërkohet dhe një plan veprimi i plotë konservimi e zhvillimi ndërsektorial, nëpërmjet mbështetjes

dhe krijimit të rrjetit përfaqësues të Zonave të Mbrojtura, si më përfaqësuesi për biodiversitetin dhe mbrojtjen e natyrës.

III. Vlerat mjedisore.

Variabiliteti i jetës është mjaft kompleks, ka ndryshuar në mënyrë dramatike gjatë kohës dhe përhapet jo në mënyrë uniforme në hapësirë. Vlerat e mjedisit mund të ndahen në dy kategori: (i) vlera të përdorshme dhe (ii) vlera të pa përdorëshme. Këto kategori nuk janë gjithmonë të ndara mirë, veçanërisht kur diskutohen vlerat e brëndëshme (të qënësishme) të mjedisit, por ato janë ndihmuese për derisa mendojmë kufizimet e tyre.

1. Vlera e përdorimit direkt.

Rrjedhim nga roli i drejtpërdrejt i burimeve biologjike në konsum ose prodhim. Shkalla e shfrytëzimit të mjedisit është e madhe dhe shumëfishët. Megjithatë të vlerësohet plotësisht vlera e mjedisit është praktikisht e pamundur. Tipet e shfrytëzimit të vlerës direkte të përdorimit të mjedisit mund të klasifikohen në disa grupe:

a. *Ushqimore.* Mjedisi siguron ushqim për njerzit në format që përfshijnë mishin, frutat, zarzavatet, plotësuesit e ushqimeve në formën e ngjyrujesve, aromatizuesit dhe konservuesit. Këto mund të vijnë nga burime të egra ose të kultivuara. Megjithatë, tani më shumë se 80% e furnizimit me ushqim për popullsinë fitohet në mënyrë direkte apo indirekte. Diversiteti i kafshëve të shfrytëzuara për ushqim është më i vështirë të llogaritet. Shkalla e gjërë e përdorimit është e dukshme. Qoftë tek kafshët dhe tek bimët, diversiteti i organizmave të shfrytëzuara për ushqim është i ngushtë, kur vihet përballë me diversitetin e përgjithshëm të tyre, duke lënë një potencial të gjërë për shfrytëzim të mëtejshëm. Kjo e parë kryesisht në mënyrë indirekte përmes përdorimit të llojeve të egra dhe varieteteve, për të dhënë gene për përmirësimin e llojeve të kultivuara.

b. *Mjekësore.* Një gamë e madhe dhe e larmishme medikamentesh përftohen, direkt ose indirekt, nga burimet biologjike. Një numër i konsideruar llojesh të bimëve të larta konsiderohen si burime potenciale për ilaçe në rajonit e Himarës. Po kështu kafshët gjejnë një përdorim ekstensiv në mjekësinë popullore.

c. *Materialet industriale.* Një rang i gjërë i materialeve industriale për prodhimin e të tilla, rrjedhin direkt nga burimet biologjike të Himarës. Ato përfshijnë materialet e prodhuara, fibra ngjyrosëse, rrëshira, lëndë ngjitëse, vajra dhe dyllra, kimikate bujqësore (përfshi pesticide) dhe parfume. Ashtu siç është rasti për ushqim dhe ilaçe, qellimi për shfrytëzimin e një diversiteti shumë të madh të organizmave për materialet industriale është i gjërë. Arsyet që është kaq më i madh se ai i realizuar aktualisht, ndoshta ka aq shumë të bëjë me faktorët kulturorë se sa me injorancën për prodhimet natyrore.

d. *Shfrytëzimi rekreativ.* Shëmbujt e shfrytëzimit rikrijues janë të shumëllojshëm, por përfshijnë gjuetinë, peshkimin dhe shfrytëzimin e bimëve e kafshëve për kopshte personale dhe publike.

e. *Ekoturizmi.* Ekoturizmi gjëndet si përkufizim në biodiversitet dhe në mjedisin natyror, duke u zhvilluar si një industri masive. Në vend të saj, turizmi si një i tërë është një nga industritë me ritje më të shpejtë në vendin tonë, pra dhe në Himarë. Megjithatë, ekoturizmi ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal është vlerësuar i ulët, duke sugjeruar që këto vlerësime paraqesin vetëm një fraksion të shkallës dhe impakteve ekonomike të ekoturizmit të rajonit të Himarës.

f. *Dëshira dhe qëndrueshmëria.* Forma të veçanta të shfrytëzimit të biodiversitetit e të natyrës mund të jenë të lidhura me disa papëlqyeshmëri. Shumë veprime të shfrytëzimit janë sigurisht jo të qëndrueshme. Disa lloje të shfrytëzuara për ushqim vazhdojnë të shkojnë drejt zhdukjes, shpyllëzimet, djegjet vazhdojnë të kalojnë ndjeshëm rigjenërimin e pyjeve, të kullotave, të bimëve mjekësore e tanifere, të ullionjëve dhe ekoturizmi mundet në disa raste të çojë në emigrim ose shpesh vdekje të shumë organizmave, të cilat njerzit vijnë për t'i parë. Rast i paqëndrueshmërisë së përdorimit është shfrytëzimi i pakontrolluar e me dinamit e mjete të ndaluara i peshkut dhe gjuetia e kafshëve dhe e shpendëve të egra. Përdorimi i paqëndrueshëm mundet të shikohet si një opsion i qëndrueshëm si një qëndrueshmëri në disa raste. Strategjia më e mirë për popullimet biologjike me

vlera do të ishte konservimi, përdorimi i qëndrueshëm i tyre, duke mënjuar tërësisht rrugët e metodat që i çojnë ato drejt zhdukjes dhe ndarja në mënyrë të barabartë e përfitimeve ekonomike.

2. Vlera e përdorimit indirekt të mjedisit.

Rrjedhin nga shumë funksione që ai kryen në sigurimin e shërbimeve, të cilat janë themelore për qënien njerzore (përmirësimet klimatike, rregullimet hidrologjike, formimin dhe mbrojtjen e tokës, të pyjeve, të kullotave, përmirësimin e ciklit të ushqimit, kontrollin e sëmundjeve, pasurimi me ozon, fotosintezën, pllenimin, kontrollin e karbonit, e etj.). Disa nga mjedise natyrore të Himarës i kanë të dyja vlerat direkte dhe indirekte. Nga pyjet e kullotat mund të sigurohen një numur i konsiderueshem i vlerave direkte të përdorimit, përfshi lëndën e drurit, bimët mjekësore, eterovajore e tanifere, produkte të tjera pyjore, gjuetinë, kullotjen e bagëtive, sanën, përdoren për çlodhje, argëtim, sport dhe turizëm. Habitatet bregdetare e detare sigurojnë prodhimet e peshkut, argëtimin, shlodhjen, plazhet, turizmin, vozitjen, etj. Në rajonin e Himarës mundet të sigurohen dhe vlera përdorimi indirekte, përfshi ruajtjen dhe prodhimtarne e tokës, mbrojtjen e shtresës së ujit, furnizimi me ujë dhe kontrollin e rrjedhjeve. Në strategjinë që mund të hartohet për rajonin mendoj se duhet një identifikim më i plotë edhe i vlerave të përdorimit indirekt, të cilat janë më të vështira për t'u vlerësuar, në krahasim me vlerat e përdorimit direkt.

3. Vlerat alternative dhe trashëguese.

Strategjia e ardhshme e Himarës duhet të marrë në konsideratë dhe vlerat alternative dhe trashëguese. Përveç se të duash mjedisin, t'a mbrosh atë për vlerat e përdorimit direkt dhe indirekt, e rëndësishme është përcaktimi i rrugëve për ruajtjen e biodiversitetit dhe për përdorimet e ardhshëm ose të pa përdorshme që ato sigurojnë. Me ruajtje të llojeve, të habitateve e të ekosistemeve dhe përfshirja e tyre në ndërtimin e strategjive të ruajtjes, i krijojmë mundësinë gjenëratës se çfarë duhet të vlerësojnë më tepër nga ato që kemi lënë pa vlerësuar apo ndoshta i kemi vlerësuar gabim ose në mënyrë të mjaftueshme. Në këtë mënyrë ne sigurojmë dhe vlerat trashëguese, vlerën e kalimit të një burimi, lloji, habitati, ekosistemi, në këtë rast të biodiversitetit, të pa prekur tek gjenëratat e ardhëshme. Pra në këtë mënyrë ne lëmë trashëgim tek gjenëratat e ardhëshme një mjedis natyror të qëndrueshëm për jetesën e çdo gjallese dhe njëherazi duhet gjithashtu që ne t'u "kompensojmë" fëmijve humbjet në këto burime natyrore, të prodhimit, të shërbimeve të mjedisit për të cilat jemi kurrëdoherë përgjegjës. Ky parim është përfshihet në Konventen e Biodiversitetit, e cila sanksionon që vendet kontraktues janë:*të detyruar të ruajnë dhe të përdorin në mënyrë të qëndrueshme diversitetin biologjik për përfitim të brezit të sotëm dhe të ardhshëm.*

4. Vlerat e brëndeshme.

Të gjithë argumentet e përmendur më sipër i kemi konsideruar të rëndësishëm për biodiversitetin e mjedisin natyror. Megjithatë, duhen parë dhe për vlerat e brëndeshme të tyre, si kënaqësinë e rrjedhur nga ndërveprimi me organizmat e gjalla, direkt ose indirekt, përmes veprimtarive ekologjike, shkencore, gjenëtike, sociale-ekonomike, edukative, kulturore, çlodhese, estetike dhe sportive (pikturë, fotografi, fluturime me deltaplane, panaire, shfaqje, muzeume, etj.). Në fakt shumë nga kulturat, historia dhe besimi kanë qënë dhe janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme me mjedisin natyror. Nocioni i mjedisit, lidhur me vlerat e brëndeshme, është gjetur gjithashtu edhe në trajtimet e Konventes për Ruajtjen e Jetës së Egër Europiane dhe Habitave Natyrore (1979, Bërnë) dhe në Kartën Botërore për Natyrën (1982).

IV. Impaktet mjedisore.

Kushtet natyrore janë optimale për zhvillimin intensiv të proceseve erozivo-denuduese, që gradualisht çojnë në degradimin e terreneve, në uljen e produktivitetit dhe, më pas, në dezertifikimin e tyre, sepse ato braktisen edhe nga njeriu. Ka qënë veprimtaria e njeriut ajo që e ka stimuluar, fuqizuar, madje shumëfishuar intensitetin e degradimit. Për të gjykuar mbi rolin e shoqërisë në këtë proces është e domosdoshme të analizohet popullimi dhe aktiviteti i njeriut në mjedis. Bazuar gjërësisht në vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e burimeve natyrore e biologjike,

rajonit i Himarës duhet të ketë politika dhe strategji zhvillimi të caktuara qartë, lidhur me administrimin dhe menaxhimin e natyrës, të biodiversitetit, të zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe të turizmit në veçanti. Gjithashtu Strategjia e menaxhimit duhet të synojë mirëmbajtjen, ruajtjen dhe përdorimin e habitateve, të ekosistemeve përbërëse dhe të burimeve të tjera natyrore, në mënyrë të tillë që funksionet ekologjike, aktivitetet tradicionale dhe social-ekonomike të jenë në harmoni të qëndrueshme e fitimprurëse, pa cënuar individët, popullatat, popullimet apo komunitetet floristike e faunistike, qofshin këto të rralla, në paksim, të kërcënuara apo në rrezik zhdukje dhe shëndetin mjedisor.

Sipërfaqe të gjëra me pyje, kullota, ullishta, pemtore, krijimi i zonave urbane e industriale pa koncepte të qarta të planifikimit të territorit, zhvillimi i veprimtarive ekonomike e sociale, etj, pa patur me parë një studim të plotë të impaktit mjedisor, sollë në degradimin e shkatërimin e natyrës. Për rehabilitimin e të cilëve kërkohen investime të mëdha dhe programe afat-gjatë. Kjo përvojë e menaxhimit jo e mirë, duhet të evidençohet në detaje dhe mbi bazën e studimeve të plota të përcaktohen objektivat, aktorët dhe buxheti për restaurimin/ripërtëritjen ekologjike të habitateve e të ekosistemeve. Në këto drejtime duhet të përfitohet nga përvoja dhe metodologjia e zbatuar në zonat e tjera, ku rigjenerimi i habitateve të nxitet me anë të përshtatjes së stimuljeve ekonomik, të informacionit mbi teknikat ekologjike të menaxhimit, krijimit të bankave gjenetike dhe bashkëpunimit me projekte bilaterale e multilaterale. Janë kryer disa studime e ndërmarrë disa projekte nga strukturat shtetërore, organizmat ndërkombetare qeveritare dhe joqeveritare, për “Administrimin e Integruar të Zonës Bregdetare”, por rezultatet e tyre lënë për të dëshiruar. Raportet e shoqërisë njerëzore me mjedisin janë tepër të ndërlikuara dhe përcaktohen nga shumë faktorë të karakterit natyror, sociale, politike, ekonomike, historike dhe shpirtërore, të cilët vazhdimisht kanë ndryshuar, duke kushtëzuar edhe pasojat mjedisore jo të njëjta të veprimtarisë njerëzore.

Duke parë në shkallë rajonit raportin midis zgjerimit të vazhdueshëm të sipërfaqeve të degraduara dhe rritjen e popullsisë e karakterin e aktivitetit të saj (zgjerim i sipërfaqes së punueshme, struktura e veçantë e bimëve të kultivuara, rritje e numurit të blektorisë, dëmtimi i vazhdueshme dhe intensiv i bimësisë, prerjet dhe djegja e pyjeve, e kullotave, e mbikullotjes, gjuetia e peshkimi i jashtëligjshëm, ndotjet urbane, mbeturinat dhe ujrat e zeza të pa trajtuara, ndërtimet pakriter e turizmi kaotik, etj), vihet re një përkeqësim i situatës. Kjo është e lidhur me faktorët natyrore, por në mënyrë të veçantë me faktorët antropogjene (njerëzore). Studimet tregojnë se edhe rajoni i Himarës, si i gjithë brezi i rivierës bregdetare, dallohet për zhvillim intensiv të këtyre proceseve, që kanë çuar apo po çojnë në degradimin e peizazheve gjeografike dhe të mjedisit në tërësi. Shkaqet e këtij degradimi intensiv lidhen me faktorët natyrorë dhe në mënyrë të veçantë me stimulimin e vazhdueshëm nga veprimtaria njerëzore mbi mjedisin natyror.

Degradimi dhe shkretëtirizimi i peizazheve përbën një nga problemet më shqetësuese mjedisore të rajonit. Ky degradim i natyrës ka pasojat më të mëdha ekonomike dhe sociale, të cilave duhet t’u paraprijmë me strategji të mirëhartuara dhe me mbështetje të plotë institucionale e financiare, duke zënë vend të rëndësishëm në programet qeveritare e lokale të zhvillimit. Për këto arsye degradimi, shkretëtirizimi dhe zhvillimi i i qëndrueshëm shoqëror e ekonomik i Himarës është bërë shqetësimi kryesor i ambientalistëve, i studjuesve të fushave të ndryshme, i komunitetit të tij dhe i “Konferencës Pan-himariote”.

Gjatë periudhës së tranzicionit u shfaqën dukuri dhe faktorë të rinj me pasojat mjedisore negative dhe pozitive. Midis dukurive me pasojat negative do të theksojmë:

- Dëmtimi me ritme të shpejta i pyjeve dhe në përgjithësi i mbulesës bimore. Ky dëmtim është rezultat i prerjeve ilegale, i djegjeve, nga mos mirëmbajtja e tyre dhe nga mosshpëtimi i sipërfaqeve të gjëlberuara. Ndërpreja e plotë e ripyllëzimeve, përmirësimeve pyjore dhe i sistemeve malore e të tokave të punueshme ka ndikimet e veta në këtë rajon.

- Braktisja e tokës së punueshme në shpatet e maleve nga banorët janë si rrjedhojë e largimit në masë të popullsisë, nga mungesa e mjeteve për të punuar tokën dhe e mundësive për të investuar, nga varfëria ekonomike dhe taksat e larta për fermerin, etj.

- Ende ka probleme të pronësisë së tokës, të cilat në mjaft rast sjellin dhe konflikte të

padëshiruara apo zaptim të saj nga personat e ardhur në rajonin e Himarës.

- Ende mbështetja ligjore dhe institucionale e mbrojtjen e tokës është e pakët dhe jo e plotë. Mungojne kontrollet periodike mbi pjellorinë e tokës, institucionet shtetërore në mbrojtje të saj, nuk zbatohen ligjet egzistuese, nuk ka asnjë organ shtetëror të specializuar për mbrojtjen e tokës nga erozioni, ndotjet dhe dëmtimet, nuk ka politika rregulluese të shtetit për stimulimin me metoda fiskale të strukturave të kulturave bujqësore, që e rruajnë tokën nga erozioni, nuk ka strategji të qartë për luften ndaj erozionit dhe nuk ka asnjë investim për këtë qëllim.

- Urbanizimi i shpejtë dhe, në shumicën e rasteve kaotik, pa plane rregullimi ka shpërdoruar tokën bujqësore, vijën bregdetare, të cilët i ka ndotur dhe degraduar.

- Privatizimi i tokës, edhe pse i pazgjidhur përfundimisht, do të ndihmojë në shtimin e kujdesit për mbrojtjen e tokës dhe të pjellorisë së saj nga faktorët dëmtues e sidomos nga erozioni dhe ndotjet. Kur e theksojmë këtë fakt si pozitiv, kemi parasysh vetëm problemin mjedisor dhe vazhdimin e sigurimit në format tradicionale të jetesës nga popullsia e zonave malore e kodrinore.

- Ende jemi larg rivlerësimit të pasurive dhe burimeve natyrore të këtyre zonave dhe menaxhimin dhe shfrytëzimin e tyre mbi bazën e koncepteve të reja, që mundësojnë mbrojtjen e pasurimin e mjedisit dhe njëkohësisht jetesën normale të popullsisë, e cila, sot po stimulohet të kthehet.

- Tendenca gjithmonë në rritje për të zhvilluar aktivitete të tjera ekonomike, që nuk dëmtojnë mjedisin ose e dëmtojnë me pak atë (blegtori, pylltari, apikultura, ekoturizmi etj.).

- Është ndotur toka nga mbetjet industriale, urbane dhe kimikatet bujqësore.

Përmbledhje dhe Konkluzione.

Vlera e përdorimit direkt të mjedisit lidhen me konsumin ose prodhimin e mallrave të rëndësishëm. Këto përfshijne ushqime, ilaçe, përdorim në kontrollin biologjik, materiale të papërpunuara industriale, shfrytëzim çlodhës dhe ekoturizëm. Shumë forma të tanishme të shfrytëzimit janë jo të qëndrueshme.

Vlera e përdorimit indirekt të mjedisit janë më të vështira të llogariten, jo të qëna subjekt të tregut, por janë më pak reale dhe të rëndësishme, duke përfshirë shumë shërbime të siguruar nga biodiversiteti që janë themelore për qënien njerëzore.

Pavarësisht vlerës së sotme të përdorimit, mjedisi mund të mbahet për opsionet për vlerat e përdorimit ose jo përdorimit që ai siguron.

Të ruash tokën, pyjet, kullotat e mjedisin është esenciale n.q.s. ne nuk duam të rrezikojmë ekzistencën tonë.

Me gjithë rëndesën e problemeve të përmendura më lart, ekzistojnë premisat dhe mundësitë për rehabilitimin e gjëndjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të mjedisit, të pyjeve, të kullotave dhe të burimeve të tjera natyrore. Roli i Qeverisë po ndryshon në drejtim të mbrojtjes dhe qeverisjes siç duhet të burimeve natyrore, duke konsideruar prioritete, ndër të tjera, mbrojtjen dhe mbarështrimin e pasurive natyrore. Të sigurohet ruajtja dhe mbrojtja e integritetit të këtyre pasurive natyrore të qëndrueshme, e në këtë kuadër edhe mbrojtja e biodiversitetit.

Në strategjitë për mbrojtjen e tokës duhet të marrin përparësi *masat parandaluese*, pasi është më efektive dhe me kosto mjaft më të ulët të meren këto masa, se sa të riparohen dëmet e ndodhura. Faktorët kryesorë që mund të shkaktojnë humbjen ose keqësimin e biodiversitetit janë:

- Humbja dhe fragmentimi i habitateve: si rezultat i shfrytëzimit të paplanifikuar, vendosjes së qendrave të banuara, shndërrimit dhe tejpërdorimit, shumë ekosisteme natyrore janë fragmentuar në copëza të vogla, duke humbur shumë nga llojshmëria biologjike dhe integriteti biologjik i tyre, sidomos në zonat fushore dhe bregdetare.

- Mbishfrytëzimi: shtimi i shpejtë i popullsisë ka çuar në mbishfrytëzimin dhe përdorimin joracional të llojeve bimore e shtazore, disa herë deri në pikën e zhdukjes së tyre.

- Ndotja e tokës, ujit dhe atmosferës: ndotësit degradojnë dhe shkatërrojnë habitatet në shkallë të ndryshme, me rrjedhojë paksimin e bile eliminimin e llojeve.

- Llojet jo vendase (të introduktuara): mund të rrezikojnë llojet e vendi, t kur marin përhapje të pakontrolluar.

Politika duhet të bazohen në parimet e ruajtjes, zhvillimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore. Mbi këtë bazë, strategjia dhe politika e zhvillimit duhet të mbështeten në këto veprime strategjike:

- transferimi gradual i përgjegjësive për qeverisjen e resurseve natyrore tek pushteti dhe komuniteti vendor;
- forcimi i rolit të shoqërisë publike e civile në qeverisjen e resurseve natyrore;
- rehabilitimi i qëndrueshëm sidomos i zonave mjedisore të ekspozuara ndaj rreziqeve të degradimit dhe i ekosistemeve të brishta.

Strategjia kombëtare të hartuara deri më sot nuk janë pasuar nga hartimi i strategjive në nivele më të ulta. Strategjia dhe planet e veprimit për zhvillimin e burimeve natyrore, të pyjeve dhe kullotave duhet të bashkërendohen më mirë me strategjitë e përdorimit të shumëfishtë të territorit, nëpërmjet sistemit të integruar agro-pyJOR-kullor të fermës, duke forcuar mbrojtjen e tokës dhe mbarështrimin e pellgjeve ujëmbledhës, si dhe nëpërmjet zgjerimit të kërkimit shkencor, shërbimit këshillimor dhe aktiviteteve të tjera.

Zhvillimi i burimeve ujore mbetet një përparësi për bujqësinë dhe sektorët e tjerë ekonomike e shoqërore. Shumëllojshmëria e peizazhit duhet konsideruar edhe si një burim i veçantë për zhvillimin e turizmit lokal, kombëtar e ndërkombëtar.

Në rrugën për asocimin në BE kërkohet që reforma politike, ligjore dhe institucionale në sektorin mjedisor e pyJOR të mbajë përqasjen gradualisht me standartet Evropiane për ruajtjen dhe qeverisjen e qëndrueshme të bnatyrës, pyjeve, kullotave dhe burimeve të tjera bio-natyrore.

Qeveria qendrore dhe organet e qeverisjes vendore, sektori i biznesit dhe sektorët e tjerë, shoqëria civile në përgjithësi, dhe të jenë me të ndërgjegjshëm për ndikimet negative të shpyllëzimeve dhe degradimeve të, në mjedisin pyJOR e kullor, duke hartuar e zbatuar programe zhvillimi afat-gjata.

Në nivel qendror

- Hartimi i akteve nënligjore dhe përmirësimi i atyre egzistuese lidhur me mbrojtjen e tokës, pyjeve, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore dhe të kultivuara;
- Hartimi i planeve dhe programeve të bashkëpunimit me institucionet dhe strukturat e tjera qendrore, për kontrollin e zbatimit të legjislacionit dhe aktiviteteve në fondin pyJOR e kullor;
- Kontrolli i zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e tokës dhe kontrollin e erozionit;
- Monitorimi i zbatimit të strategjive dhe politikave për mbrojtjen e tokës e të pyjeve nga dëmet, veprimtaritë ilegale dhe nga zjarret.

Në nivel lokal

- Hartimi i planeve dhe programeve të veprimit për kontrollin e zbatimit të planeve të mbarështrimit të tokës, pyjeve, kullotave, peshkimit e burimeve të tjera bio-natyrore, pavarësisht nga statusi dhe forma e pronësisë së tyre;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet shtetërore, dhe shoqatat e ndryshme për zbatimin e planeve dhe programeve të veprimit, në përputhje me detyrimet ligjore të tyre e kompetencave, për kontrollin e degradimit e të shkatërimit të tokës, pyje, kullotave etj;
- Monitorimi i realizimit të planeve dhe programeve të veprimit, në kuadrin e realizimit të objektivave strategjike lokale;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me strukturat rajonale të institucioneve të tjera, mbi zbatimin e ligjshëmërisë në aktivitetet që zhvillohen nga subjektet e ndryshëm në fondin pyJOR e kullor shtetëror, komunal e privat;
- Bashkëpunimi dhe rakordimi i programeve dhe masave me strukturat rajonale dhe vendore, për shuarjen e zjarreve në pyjet e kullotat shtetërore, komunale dhe private;
- Zbatimi i planit të mbarështrimit të pyjeve komunal dhe ndërmarrja e hapave për ripyllëzimin e rugave kombëtare e lolake që përshkojnë Himarën, në krijimin e sipërfaqeve të gjelbërta rreth fshatrave dhe në zonat turistike, në sistemimin e pellgjeve ujëmbledhës të përrenjëve me erozion të lartë, në përmirësimin e kullotave dhe sigurimin e ujit të pijshëm në to për blegtorinë, në grumbullimin dhe përpunimin e bimëve mjekësore e tanifere dhe ruajtjen e valanidhit, etj.

Pra problemet që shoqërojnë Himarën për ruajtjen e tokës, të pyjeve, të kullotave, të biodiversitetin e të burimeve të tjera bio-natyrore, të ndotjes, etj., nuk janë vetëm biologjike, por janë gjithashtu politike, ekonomike, sociale, madje edhe etike për nga natyra. Masat konservuese plotësohen nga organizmat e pushtetit vendor, politikanët, banorët, biznesmenët dhe specialistët përkatës.

Summary.

THREATS TO ENVIRONMENTAL DEGRADATION OF THE NATURAL RESOURCES OF HIMARA AND THE NEED FOR A CONSERVATION STRATEGY

PREPARED BY KOZMA KOCANI, GENTI KROMIDHA, NIHAT DRAGOTI

The southern coastal region is rich on natural resources and biodiversity, historical, cultural, traditional, and archeological values that need to be preserved and wisely used for the benefit of the whole area. Himara region lies on an area of about 32'318 hectares. the area consists of a variety of natural habitats including forests, pastures, olive yards, rocky beaches, river mouths and watercourses, etc. Some ecologically important areas are still untouched and they require special care from the management authorities, both local and central government, especially regarding their preservation and sustainable use.

The villages of dhermiu, palasa, vunoj, himara, qeparo, piluri, kudhesi, and iliazi, have plenty of traditional, cultural, archeological, and historical values that need to be identified and protected. these heritage values create opportunities for the development of the himara region considering an expanding market for tourism and eco-tourism activities.

The future development of the region is strictly associated with the status and preservation of its natural environment and its ability to mitigate impacts from human development activities.

The environmental issues concerning this area regard both ecological and socio-economic aspects. Adequate conservation measures should be identified and implemented by local government with the support of decision makers at different levels. There is a strong need for coordination among interested parties and institutions in order to realize and successfully implement nature conservation activities.

The coastal region of himara needs an action plan for biodiversity protection and identification of different protected areas according to their ecological conditions and sustainable use requirements. nature conservation must provide the guiding principles for identifying possible tourist activities and infrastructure interventions causing the minimum impact on the biodiversity resources of the area and preserving the natural landscapes and different habitats and land use patterns.

The nature degradation is becoming a real concern for the himara region, so it is important that everyone work toward sustainable socio-economic development of the region. the economic development of the coastal area will continue to promote the migration of people towards these areas. This will lead to an increased population number with higher requests for settlements and other natural resources. The urbanization process of these areas is closely linked to environmental impacts, so the successful future development definitely requires the development and implementation of sound environmental policies in order to balance socio-economic development with biodiversity and nature protection requirements.

Literatura:

1. Instituti Hidrometeorologjik, "Atlasi Klimatik i Shqipërisë" (1990), Tiranë.
2. Instituti Hidrometeorologjik, "Hidrologjia e Shqipërisë" (1985), Tiranë.
3. Instituti i Studimeve të Tokave, "Harta e Tokave të Shqipërisë" (1999), Tiranë.

4. Krutaj F, Qiriaz P. “Ndikimi i proceseve të jashtme në modelimin e relievit shqiptar” (1987), Studime Gjeografike nr, 2. Tiranë.
5. Krutaj F. “Antropizimi i relievit dhe pasojat e tij në Shqipëri” (1997), Studime Gjeografike Nr.9. Tiranë.
6. Leka I. “Erozioni, specifikat dhe përmasat e tij në Shqipëri” (1996), Studime Gjeografike Nr. 8. Tiranë.
7. Atlas of Mediterranean Environments in Europe: “The Desertification Context Hardcover”, 1997.
8. Konventa Ndërkombëtare kundër Dezertifikimit, “Mbi dezertifikimin”, Seminar Kombëtar (1998), Tiranë.
9. Kovaçi V, Belalla S. “Erozioni, dëmet që ka sjellë, problemet që kërkojnë rrugëzgjdhje në të Ardhmen” (1998), Seminar Kombëtar Ndërgjegjësimi, Tiranë.
10. Leka Sh. “Urbanizimi i pakontrolluar, një kërcënim në rritje për degradimin e tokës” (1998), Seminar Kombëtar Ndërgjegjësimi, Tiranë.
11. Malaj K. “Shpyllëzimet, ecuria, shkretëtirizimi i tokës nga shpyllëzimi” (1998), Seminar Kombëtar Ndërgjegjësimi, Tiranë.
12. Meçaj N, etj. “Humanizimi i mjedisit dhe rreziku i shkretëtirizimit në Shqipëri” (1998), Seminar Kombëtar Ndërgjegjësimi, Tiranë.
13. Qilimi B, Halimi E, Osmani R. “Shkretëtirizimi i tokës në Shqipëri, problemet, hapat që duhet të ndërmerren” (1998), Seminar Kombëtar Ndërgjegjësimi, Tiranë.
14. Qiriaz P. ”Degradimi i terreneve në vendin tonë dhe problemet sociale që lidhen me të” (1994), Studime Gjeografike nr. 5, Tiranë.
15. Qiriaz P. “Probleme të degradimit të terreneve gjatë periudhës së tranzicionit”(1996). Studime Gjeografike, nr. 8, Tiranë.
16. Qiriaz P, Sala S. “Harta e intensitetit të erozionit në Shqipëri” (1992), Tiranë.
17. Xinxo M. “Erozioni i ujërave rrjedhëse në Shqipëri” (1985), Tiranë.
18. DPSHP, “Plani i Menaxhinmit të Pyjeve Komunal të Himarës” (2000), Tiranë.
19. ANFI. “Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve”, (2004), Tiranë.
20. DPSHP. “Strategjia e zhvillimit të sektorit të Pyjeve dhe Kullotave” (2004), Tiranë.